



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 972/ Prot.

Tiranë, më 04.05.2026

VENDIM

Nr. 04, Datë 04.05.2026

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT TË
ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE
INOVACIONIT DHE SHTOJCAVE

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 04.05.2026,

VENDOSI:


1. Miratimin e Rregullores për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe shtojcave (dokumentacioni bashkëlidhur këtij vendimi);
2. Përcjelljen pranë Ministrisë së Arsimit për miratim të Rregullores për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
3. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Znj. Armela Baka, Kryetar 

Z. Erjon Uka, Anëtar; 

Znj. Mirela Cami, Anëtar; 



Znj. Juljana Margariti, Anëtar; 
Znj. Anisa Subashi, Anëtar;
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar;
Znj. Ines Muçostepa Anëtar;

RREGULLORE

PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT



Miratuar me URDHËR MINISTRI I ARSIMIT
Nr. _____, datë _____, 2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

RREGULLORE

Nr. _____, datë _____.____.2026

**PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Në mbështetje të neneve 12 dhe 47 të Ligjit Nr 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Ligjit Nr 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", me propozim të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, sipas pikes 10, Ministria e Arsimit vendosi miratimin e Rregullores "Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", si më poshtë:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka si qëllim vendosjen e rregullave të përgjithshme për organizimin, funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe procedurat me të cilat Bordi i Administrimit të AKKSHI do të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë, detyrat e kryetarit, të sekretarit dhe të anëtarëve të Bordit të Administrimit të AKKSHI, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

**Neni 2
Përkufizime**

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizohet dhe funksionon nëpërmjet organeve dhe autoriteteve drejtuese të saj, të cilat janë bordi i administrimit dhe drejtori i Përgjithshëm.

Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.



Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe rregullores së tij të brendshme, të miratuar nga ministri i Arsimit.

Neni 3

Funksionet e Bordit të Administrimit të AKKSHI

Në përmbushje të përgjegjësisë të tij ligjore Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit - AKKSHI ushtron këto funksione:

- a) Miraton, përpara miratimit nga Ministria e Arsimit, fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit që do të financohen;
- b) Miraton përbërjen e komisioneve të ekspertëve të vlerësimit të programeve dhe projekteve, sipas fushave të shkencës;
- c) Miraton aktet e brendshme të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- ç) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- d) Miraton financimin e projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit dhe projektet e studimeve të doktoratës, bazuar në:
 - i) fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të miratuara nga Ministria e Arsimit e Sportit;
 - ii) grantin e punës kërkimore-shkencore;
 - iii) vlerësimin e komisioneve të ekspertëve të programeve dhe projekteve.
- d) Miraton rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë përpara se këto rezultate dhe renditja përfundimtare t'i komunikohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;
- e) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda katërmujorit të parë të vitit pasardhës, i cili bëhet publik.

Neni 4

Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit

- 4.1. Përbërja e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI rregullohet sipas përcaktimeve të pikës 8 të VKM Nr.464, datë 31.07.2025 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit –AKKSHI".
- 4.2. Anëtarët e Bordit të Administrimit që përfaqësojnë institucionet shtetërore përcaktohen nga titullari i institucionit përkatës, si dhe emri dhe pozicioni janë të komunikuar tek Kryetari dhe Sekretari i Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI.
- 4.3. Bordi i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që kryesohet nga ministri



përgjegjës për shkencën dhe kërkimin shkencor ose zëvendësministri i autorizuar prej tij dhe ka në përbërje:

- a) ministrin përgjegjës për inovacionin;
- b) dy përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Arsimit;
- c) drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;
- ç) drejtorin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;
- d) përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë;
- dh) përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve;
- e) përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Neni 5

Kryetari i Bordit të Administrimit të AKKSHI

- 5.1. Kryetari i organit kolegjal, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjen, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
- 5.2. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës.
- 5.3. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, të votohet nga shumica e anëtarëve të bordit dhe të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
- 5.4. Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje.
- 5.5. Kryetari ose çdo anëtar tjetër i Bordit të Administrimit të AKKSHI, ka të drejtë të bëjë ankime në gjykatën administrative kundër vendimeve të marra nga ky organ dhe të kërkojë pezullimin e zbatimit të tij, kur çmon se vendimi është i kundërligjshëm.

Neni 6

Sekretari i Bordit të Administrimit të AKKSHI

- 6.1. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI luan rolin e Sekretarisë së Bordit të Administrimit të AKKSHI dhe administron të gjithë dokumentacionin që pasqyron punën e Bordit.
- 6.2. Sekretaria e Bordit të Administrimit të AKKSHI:
 - merr masa teknike për organizimin e mbledhjeve të programuara,
 - kryen njoftimin,
 - përgatit dhe shpërndan materialet përkatëse të mbledhjes në kohë për secilin anëtar,
 - ndjek detyrat e përcaktuara nga mbledhja e Bordit të Administrimit të AKKSHI.
- 6.3. Mban procesverbalin/ minutat e mbledhjes.
- 6.4. Garanton ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit sipas legjislacionit në fuqi.
- 6.5. Raporton rregullisht, çdo mbledhje, për zbatimin e vendimeve dhe detyrave të lëna në mbledhjen e radhës së Bordit të Administrimit të AKKSHI.



Neni 7

Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit dhe sekretarit

- 7.1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, kryetari dhe sekretari i Bordit të Administimit të AKKSHI zëvendësohen përkohësisht, përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë, që të dy me të drejtë vote.
- 7.2. Në rastet kur anëtarët me të drejtë vote kanë shërbyer si anëtarë për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshëm do të bëhet përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga ai më i riu në moshë.

KREU 2

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 8

Mbledhjet e Bordit të Administrimit të AKKSHI

- 8.1. Mbledhja e Bordit të Administrimit të AKKSHI drejtohet nga Kryetari Bordit të Administimit të AKKSHI.
- 8.2. Kryetari i Bordit të Administimit të AKKSHI vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë organi ka vendosur ndryshe.
- 8.3. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtari të Bordit të Administimit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
- 8.4. Bordi i Administrimit të AKKSHI mblidhet periodikisht, sipas nevojës, por jo më pak se dy herë në vit. Në raste të veçanta, me propozim të kryetarit, bordi mund të mblidhet në mbledhje jashtë radhe.

Neni 9

Thirrja e mbledhjeve

- 9.1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI, ose nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
- 9.2. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, të paktën 48 orë përpara datës së thirrjes të mbledhjes.
- 9.3. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet (draft rendin e ditës) dhe përmban detyrimisht datën, vendin, orën.

Neni 10

Rendi i ditës

- 10.1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë



propozuar atij nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI ose anëtarët e Bordit të Administrimit me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen.

11.2. Rendi i ditës duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

Neni 12

Marrja e vendimeve

12.1. Bordi i Administrimit të AKKSHI merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

12.2. Bordi i Administrimit vendos me shumicë votash dhe në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e kryetarit të Bordit të Administrimit.

12.3. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të kemi përsëri një barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur, me përfundim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 13.

Neni 13

Mbledhjet e hapura

13.1. Në bazë të Nenit 9 të Ligjit Nr 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore", Bordi i Administrimit të AKKSHI si organ kolegjial jo i zgjedhur nuk zhvillon mbledhje të hapura.

13.2. Në raste të veçanta dhe me vendim të 2 /3 të anëtarëve të Bordit të Administrimit mund të zhvillohen mbledhje të hapura ku njoftohet data, ora dhe vendi i mbledhjes, në mënyrë që të garantohet njoftimi i palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të paktën 48 orë përpara datës së mbledhjes.

Neni 14

Thirrja e mbledhjeve në kundërshtim me rregullin

Mbledhja e Bordit të Administrimit të AKKSHI është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.



Neni 15 Kuorumi

- 15.1. Mbledhja e Bordit të Administrimit të AKKSHI, është e vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
- 15.2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një dite tjetër, të paktën 24 orë pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 16 Votimi i detyrueshëm

Anëtarët e Bordit të Administrimit të AKKSHI, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 17 Forma e votimit

- 17.1. Vendimet merren me votim të hapur përveç rasteve kur dispozitat ligjore parashikojnë ndryshe.
- 17.2. Kryetari i Bordit të Administrimit voton i fundit.
- 17.3. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë.
- 17.4. Ata anëtarë të Bordit të Administrimit të AKKSHI që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit. Anëtarët që kanë konflikt interesi duhet të bëjnë me dije konfliktin e interesit dhe të heqin dorë nga pjesëmarrja në vendimmarrje për çështje konkrete. Konflikti i interesit deklarohet me shkrim dhe pasqyrohet në procesverbal.

Neni 18 Procesverbali i mbledhjes

- 18.1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
- 18.2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.
- 18.3. Në rastet kur vetë Bordi i Administrimit të AKKSHI e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.



18.4. Vendimet jonormative hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.

Neni 19

Zbatueshmëria e Vendimeve

Çdo vendim që merret në mbledhjet e Bordit të Administrimit duhet të zbardhet me një numër rendor më vete, të firmoset nga të gjithë anëtarët e Bordit të pranishëm e Kryetari, sipas radhës së vendimeve e të protokollohet pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit - AKKSHI dhe përcillet me shkrim për informim në Ministrinë e Arsimit.

Neni 20

Transparenca dhe publikimi

- 20.1. Bordi i Administrimit garanton transparencën e veprimitarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe funksionimin e organeve publike.
- 20.2. Vendimet kryesore të Bordit, që lidhen me politikat, prioritetet, financimet dhe aktet e brendshme, publikohen në faqen zyrtare të AKKSHI, brenda një afati të arsyeshëm pas miratimit të tyre.

Neni 21

Etika dhe integriteti

- 21.1. Anëtarët e Bordit të Administrimit ushtrojnë detyrën e tyre në përputhje me parimet e ligjshmërisë, integritetit, paanshmërisë, profesionalizmit dhe transparencës.
- 21.2. Anëtarët veprojnë në interes të misionit të AKKSHI dhe shmangin çdo situatë që mund të cenojë besimin publik në vendimmarrjen e Bordit.
- 21.3. Anëtarët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrës, i cili nuk është publik, edhe pas përfundimit të mandatit të tyre.
- 21.4. Çdo shkelje e parimeve të etikës dhe integritetit trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund të sjellë masa administrative, ose të tjera sipas rastit.

Neni 22

Shpërblimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit të AKKSHI

Në bazë të pikës 11, të VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, kryetari dhe anëtarët e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.



Neni 23
Hyrja në fuqi dhe amendime

- 23.1. Rregullorja për funksionimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI dhe shtojcat hyjnë në fuqi pas miratimit në mbledhjen përkatëse të Bordit të Administrimit të AKKSHI dhe miratimit nga Ministria e Arsimit, bazuar nr VKM Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI", pika 10, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- 23.2. Rregullorja për funksionimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI mund të jetë subjekt ndryshimi me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Neni 24
Dispozita të fundit

Për çështjet e patrajtuara në këtë rregullore Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit do të zbatojë dispozitat e Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Ministria e Arsimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

Lënda: Njoftim për pjesëmarrje në mbledhjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

**ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

KRYETARIT, MINISTRIT TE ARSIMIT, ZNJ./ Z. _____

MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR INOVACIONIN, ZNJ./ Z. _____

MINISTRISË SË ARSIMIT, ZNJ./ Z. _____

DREJTORI I AGJENCISË KOMBËTARE TË FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË ZNJ./ Z. _____

DREJTORI I AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË ZNJ./ Z. _____

AKADEMIA E SHKENCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ZNJ./ Z. _____

KONFERENCA E REKTORËVE, ZNJ./ Z. _____

BASHKIMI I DHOMAVE TË TREGTISË DHE INDUSTRIË SË SHQIPËRISË, ZNJ./ Z. _____

Në mbështetje të neneve 12 dhe 47 të Ligjit Nr 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Ligjit Nr 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Rregullores "Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit",

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në rolin e Sekretarit të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ju njofton për pjesëmarrje në mbledhjen e Bordit të Administrimit të AKKSHI.

■ **Adresa:** Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë

■ **Email:** info@nasri.gov.al

- **Web:** www.nasri.gov.al
- **Ora:** 16:00
- **Data:** 23.04.2026

Mbledhja do të mbahet pranë ambienteve të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në datë ____.____._____, ora ____:____.

Kohëzgjatja e mbledhjes parashikohet jo më shumë se 1 orë.

Bashkëngjitur do të gjeni rendin e ditës.

ZNJ./ Z. _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT



AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

RENDI I DITËS

MBLEDHJE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

- **Adresa:** Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë
- **Email:** info@nasri.gov.al
- **Web:** www.nasri.gov.al
- **Ora:** ____:00
- **Data:** _____._____.2026

PROGRAMI

- Ora 11:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve
- Ora 11:10** Hapja e takimit
Kryetari i bordit të administrimit
Znj./ Z. _____
Ministër i Arsimit
- Ora 11:15** Prezantim i çështjeve për diskutim
Znj./ Z. _____
Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
1. _____
2. _____
3. _____
- Ora 11:30** Diskutime |
Votim i anëtarëve sipas çështjeve në rendin e ditës
- Ora 12:00** Mbyllja e takimit

SHTOJCA 01

PROCES VERBAL I MBLEDHJES SË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

- **Adresa:** Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë
- **Email:** info@nasri.gov.al
- **Web:** www.nasri.gov.al
- **Ora:** ____:00
- **Data:** ____, ____, 2026

PROGRAMI

- Ora 11:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve
- Ora 11:10** Hapja e takimit
Kryetari i bordit të administrimit
Znj./ Z. _____
Ministër i Arsimit
- Ora 11:15** Prezantim i çështjeve për diskutim
Znj./ Z. _____
Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
1. _____
2. _____
3. _____
- Ora 11:30** Diskutime |
Votim i anëtarëve sipas çështjeve në rendin e ditës
- Ora 12:00** Mbyllja e takimit

PROCES VERBAL I MBLEDHJES
BORDI I ADMINISTRIMIT | AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

1

Znj./Z. Ministër i Arsimit, Kryetar; _____

Znj./Z. AKFAL, Anëtar; _____

Znj./Z AKKSHI, Sekretar; _____

Znj./Z. ASCAL, Anëtar; _____

Znj./Z Ministria e Inovacionit, Anëtar; ____

Znj./Z. Akademia e Shkencave, Anëtar; ____

Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Konferenca e Rektorëve, Anëtar; ____

Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Dhoma e Tregëtisë, Anëtar; _____

1. HAPJA E TAKIMIT

2. FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Ora 11:15 Prezantim i ceshtjeve per diskutim
Znj./ Z. _____
Drejtore i Përgjithshëm
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Znj./Z. Ministër i Arsimit, Kryetar; _____
Znj./Z AKKSHI, Sekretar; _____
Znj./Z Ministria e Inovacionit, Anëtar; ____
Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____
Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. AKFAL, Anëtar; _____
Znj./Z. ASCAL, Anëtar; _____
Znj./Z. Akademia e Shkencave, Anëtar;____
Znj./Z. Konferenca e Rektorëve, Anëtar; __
Znj./Z. Dhoma e Tregëtisë, Anëtar; _____

3. DISKUTIME

Ora 11:30

Diskutime |

Votim i anëtarëve sipas çështjeve në rendin e ditës

4. MBYLLJA E TAKIMIT | DETYRAT E LËNA PËR ZBATIM

Znj./Z. Ministër i Arsimit, Kryetar; _____

Znj./Z. AKFAL, Anëtar; _____

Znj./Z AKKSHI, Sekretar; _____

Znj./Z. ASCAL, Anëtar; _____

Znj./Z Ministria e Inovacionit, Anëtar; ____

Znj./Z. Akademia e Shkencave, Anëtar; ____

Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Konferenca e Rektorëve, Anëtar; ____

Znj./Z Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Dhoma e Tregëtisë, Anëtar; _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

VENDIM

Nr. _____, Datë _____._____.2026

PËR
RISHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PUNONJËSIT KËRKIMORË-SHKENCORË TË PROGRAMIT
_____, PER VITIN 2025

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), Marrëveshjes së bashkëpunimit, vendimit të Bordit të Administrimit të AKKSHI nr.____, datë _____._____._____, "Rishpërndarjen e fondit për punonjësit kërkimorë-shkencorë të programit _____, per vitin 2025", si dhe të kërkesës së paraqitur nga _____ në datën _____._____._____, në mbledhjen e datës _____._____._____, bordi i administrimit të AKKSHI-së,

VENDOSI:

- AKKSHI të vijojë me procedurat për rishpërndarjen e fondit për punonjësit kërkimorë-shkencorë të shpallur fitues në kuadër të _____, për vitin 2025, sipas marrëveshjes me _____ dhe legjislacionit në fuqi.
- _____
- Ngarkohet AKKSHI të kryejë kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve sipas afateve dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT | AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

1

Znj./Z. Ministër i Arsimit, Kryetar; _____

Znj./Z. AKFAL, Anëtar; _____

Znj./Z. ASCAL, Anëtar; _____

Znj./Z. Ministria e Inovacionit, Anëtar; _____

Znj./Z. Akademia e Shkencave, Anëtar; _____

Znj./Z. Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Konferenca e Rektorëve, Anëtar; _____

Znj./Z. Ministria e Arsimit, Anëtar; _____

Znj./Z. Dhoma e Tregëtisë, Anëtar; _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më ____ . ____ .2026

Lënda: Dërgohen vendimet e marra në mbledhjen e datës 04.05.2026 të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

MINISTRISË SË ARSIMIT

Adresa: Rruga e “Durrësit”, nr. 23, Tiranë

Në mbështetje të neneve 12 dhe 47 të Ligjit Nr 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, Ligjit Nr 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, Rregullores “Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”,

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dërgon për informacion bashkëngjitur vendimet e marra në mbledhjen e datës 04.05.2026 të Bordit të Administrimit të AKKSHI-së.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi:

Nr. i kopjeve : 4 (katër)

LISTË PREZENCA

MBLEDHJE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

- **Adresa:** Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë
- **Email:** info@nasri.gov.al
- **Web:** www.nasri.gov.al
- **Ora:** ____:00
- **Data:** _____, _____, 2026

Pozicioni	Emër, Mbiemer	Adresa mail	Nënshkrimi
1	Ministër i Arsimit, Kryetar		
2	Ministria e Inovacionit		
3	Ministria e Arsimit		
4	Ministria e Arsimit		
5	AKFAL		
6	ASCAL		
7	Akademia e Shkencave, Anëtar		
8	Konferenca e Rektorëve		
9	Dhoma e Tregëtisë, Anëtar		
10	Sekretar		
11			
12			

LISTË PREZENCA |

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

NË ZBATIM TË RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)

Në zbatim të Rregullores "Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", si dhe të legjislacionit në fuqi, në veçanti Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër përkatës që rregullon trajtimin e informacionit,

Unë, i nënshkruari/a _____, në cilësinë e anëtarit/es së Bordit të Administrimit të AKKSHI,

DEKLAROJ SE:

- Jam njohur me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe nga Rregullorja e Bordit të Administrimit të AKKSHI lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit.
- Angazhohem të ruaj konfidencialitetin e çdo informacioni, dokumenti apo të dhëne që më vihet në dispozicion gjatë ushtrimit të detyrës sime dhe që nuk është publik.
- Angazhohem të mos përdor këtë informacion për përfitime personale apo për interes të palëve të treta.
- Angazhohem të mos zbuloj, publikoj apo shpërndaj informacion konfidencial, në asnjë formë, pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur kjo kërkohet nga ligji.
- Ky detyrim për ruajtjen e konfidencialitetit vijon të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të mandatit tim si anëtar i Bordit të Administrimit të AKKSHI.
- Jam i vetëdijshëm/e se çdo shkelje e këtij detyrimi mund të sjellë pasoja ligjore dhe administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Emri, Mbiemri: _____

Funksioni: Anëtar i Bordit të Administrimit të AKKSHI

Data: _____._____.2026

Nënshkrimi: _____

DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

NË ZBATIM TË RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)

Në zbatim të Rregullores "Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", si dhe të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar,

Unë, i nënshkruari/a _____, në cilësinë e anëtarit/es së Bordit të Administrimit të AKKSHI,

DEKLAROJ SE:

- Jam njohur me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe rregullorja e Bordit lidhur me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit.
- Në lidhje me çështjen/çështjet në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit të Administrimit të datës _____._____.2026:
 Nuk kam konflikt interesi
 Kam konflikt interesi (plotëso pikën 3 më poshtë)
- Në rast se ekziston konflikt interesi, ai lidhet me (përshkruani natyrën e interesit privat, lidhjen me subjektin/çështjen, etj.):

-
- Në përputhje me Ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, dhe rregulloren përkatëse, angazhohem të:
 - deklaroj në mënyrë të plotë dhe të saktë çdo konflikt interesi aktual apo të mundshëm;
 - tërhiqem nga pjesëmarrja në diskutim dhe vendimmarrje për çështjen përkatëse;
 - shmang çdo ndikim të padrejtë në procesin vendimmarrës.
 - Jam i vetëdijshëm/e se mosdeklarimi, deklarimi i pasaktë apo fshehja e konfliktit të interesit përbën shkelje të legjislacionit në fuqi dhe sjell përgjegjësi administrative dhe/ose ligjore.
 - Kjo deklaratë depozitohet pranë Sekretarisë së Bordit dhe pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

Emri, Mbiemri: _____

Funksioni: Anëtar i Bordit të Administrimit të AKKSHI

Data: _____._____.2026

Nënshkrimi: _____

DEKLARATE KONFIDENCIALITETI |